



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 8396 Prot.

Tirane, me 30-03 2016

UDHËZIM

Nr. 1/2, datë 30-03 2016

Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 01, datë 06.09.2012 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv – i ndryshuar”

Në zbatim të Ligjit Nr. 8449, datë 27.01.1999 “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë” Pjesa IV e tij - Destinacioni Doganor, Kreu 2 - Regjimet Doganore, Seksioni 3 - Regjimet pezulluese dhe regjimet doganore ekonomike Neni 107 - 112 dhe gërma D - Përpunimi Aktiv - Neni 136 -149, si dhe pikat 234 – 239, 272-325 dhe 463 - 472 të Dispozitave Zbatuese të Vendimit të Këshilli të Ministrave Nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, në lidhje me regjimin e Përpunimit Aktiv;

Me qëllim lehtësimin e procedurave doganore për shoqëritë që kanë aktivitet nën Regjimin e Përpunimit Aktiv, si dhe për të shmangur vonesat që mund të çojnë në pengimin e vijimësisë së aktivitetit të tyre;

Bazuar në nenin 325 të VKM nr.205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” të ndryshuar”;

UDHËZOJ:

Delegimin e kompetencave, pranë Zyrave Doganore Mbikqyrëse, për të miratuar ndryshimet/shtesat në autorizimin e RPA-së, të parashikuara në pikat 4 dhe 5 të nenit 3 të Udhëzimit nr. 01, datë 06.09.2012 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv- i ndryshuar”

Pikat 4 dhe 5 të nenit 3 do të zëvendësohen me përmbajtjen si më poshtë:

4. Në rastet kur, gjatë kohëzgjatjes së Autorizimit për Përpunim Aktiv, lind nevoja e ndryshimeve ose shtesave të mundshme si rrjedhojë e ndryshimeve kontraktuale pjesërisht ose tërësisht; si dhe në rastet kur lind nevoja e ndryshimit të përmbajtjes së një ose disa pikave të Autorizimit për shkak të ndryshimit të rrethanave që kushtëzojnë funksionimin e aktivitetit, mbajtësi i autorizimit duhet të paraqesë, pranë Zyrës Doganore Mbikqyrëse të përcaktuar në

autorizim, një kërkesë më shkrim në të cilën përshkruhen të gjitha argumentimet e nevojshme që justifikojnë ndryshimet apo shtesat.

5. Delegimi i kompetencave do të bëhet për ndryshimet/shtesat në pikat 1, 3, 4, 5, 6, 7,8 dhe 9 të autorizimit të RPA-së (sipas Aneksit nr. 32 i Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor). Në të gjitha rastet do të vepohet si me poshte:

- **Ndryshimet në pikën 1 të autorizimit:** *Emri ose emri i firmës dhe adresa:*

- Për ndryshimet në pikën 1/a "*i mbajtësit të autorizimit të autorizimit*" – kërkesa duhet të shoqërohet me një kopje të NIPT-it ku janë pasqyruar të dhenat e ndryshuarara lidhur me emrin ose adresën e mbajtësit të autorizimit.
- Për ndryshimet/shtesat në pikën 1/b "*e operatorit*" – kërkesa duhet të shoqërohet me; marrëveshjen/marrëveshjet ndërmjet operatorit/operatorëve dhe mbajtësit të autorizimit, kopje e NIPT-it dhe deklaratë nga operatori/operatorët për adresën e sakte të ambienteve të perpunimit si dhe disponueshmërinë për kontroll nga autoritetet doganore.

- **Ndryshimet në pikën 3 të autorizimit:** *Mallrat për perpunim:*

- Për ndryshime/shtesa në pikën 3/a dhe 3/b të autorizimit "*përshkrimi tregëtar ose teknik*" dhe "*treguesit e klasifikimit të NK*" – kërkesa duhet të paraqesë argumenta mbi përdorimin e këtyre mallrave në procesin e prodhimit ose të shoqërohet me karta teknologjike. Autoritetet doganore të zyrës mbikqyrese duhet të kujdesen që mallrat për perpunim (lende të para, materiale ndihmese e aksesore) që do të shtohen autorizimit, për sa i përket përshkrimit të tyre dhe pozicionit tarifor, të jenë pjesë e produkteve kompensuese të autorizuara duke u mishëruar në to, bazuar në verifikimin e kartave teknologjike, modeleve dhe mostrave.
- Për ndryshimet/shtesat në pikat 3/c dhe 3/d "*sasia dhe vlera e autorizuar*" – kërkesa duhet të shoqërohet me marrëveshjen/marrëveshjet me shoqërinë porositëse (të huaj) në të cilën parashikohen ndryshimet/shtesat e kërkuara.

- **Ndryshimet në pikën 4 të autorizimit:** *Produktet kompensuese:*

- Për ndryshimet/shtesat në pikat 4/a, dhe 4/b të autorizimit "*përshkrimi tregëtar ose teknik*" dhe "*treguesit e klasifikimit të NK*" kur produktet kompensuese ndryshojnë nga ato të miratuara ose do të prodhohen produkte kompensuese të tjera shtese – kërkesa shoqërohet me marrëveshjen me shoqërinë porositëse (të huaj) në të cilën parashikohen ndryshimet e kërkuara si dhe kartat teknologjike përkatëse. Autoritetet doganore të zyrës mbikqyrese do të kujdesen që produktet kompensuese që do të shtohen të jenë të se njëjtes kategori mallrash dhe rrjedhore të mallrave për perpunim të miratuara

- **Ndryshimet në pikën 5 te autorizimit:** *Koeficienti i shfrytëzimit, mënyra e përcaktimit të tij:*
 - Për ndryshime/shtesa në pikën 5 të autorizimit – kërkesa duhet të shoqërohet me kartën teknologjike që pasqyron ndryshimin e kërkuar.

- **Ndryshimet në pikën 6: Lloji i përpunimit:**
 - Për ndryshime/shtesa në pikën 6 të autorizimit – kërkesa duhet të shoqërohet me një përshkrim të hollesishëm të procesit teknologjik të prodhimit me ndryshimet e kërkuara.

- **Ndryshimi në pikën 7: Vëndi ku do të kryhet përpunimi:**
 - Në rastet kur ambjentet e përpunimit (reparti) dhe selia e mbajtesit të autorizimit janë në të njëjtin vend/adrese, kur bëhen ndryshime në pikën 1/a dhe 1/b të autorizimit ato duhet të pasqyrohen dhe në pikën 7 të këtij autorizimi.
 - Në rastet kur rastet ambjentet e përpunimit (reparti) dhe selia e mbajtesit të autorizimit nuk janë në të njëjtin vend/adrese – kërkesa për të ndryshuar/shtuar në pikën 7 të autorizimit vëndin/adresën e ambjenteve të përpunimit do të shoqërohet me kopje të dokumentacionit të pronësive të këtyre ambjenteve (në varësi të rastit; kontrate qeraje, certifikate pronësie, etj)

- **Ndryshimi në pikën 8: Kufiri kohor për riekportim:**
 - Për ndryshimet/shtesat në pikën 8 të autorizimit – kërkesa duhet të argumentojë arsyet/kushtet që kanë çuar në ndryshimin e afatit të riekportimit të deklaruar.

- **Ndryshimi në pikën 9: Metoda e aprovuar e identifikimit:**
 - Për ndryshimet në pikën 9 të autorizimit dega doganore në varësi të rasteve të paraqitura gjatë aktivitetit nën regjim mund të bëjë ndryshime në lidhje me mënyrën e identifikimit të produkteve.

- Ndryshimet/shtesat në pikën 2, 10 dhe 11 të autorizimit do të vazhdojnë të miratohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Në nenin 3 shtohen dhe pikat:

6. Të gjitha ndryshimet/shtesat e miratuara nga dega doganore do të administrohen në dosjen e regjimit sipas nenit 15 të Udhëzimit nr. 01, datë 06.09.2012 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv” i ndryshuar dhe kopje të tyre do t’i bashkëlidhen autorizimit të RPA-së të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe janë të zbatueshme dhe në degët doganore të tjera të përcaktuara në autorizimin e RPA-së të ndryshme nga ajo mbikqyrëse.

7. Ne Proces-Verbalin perfundimtar (dokumentin permbylles te regjimit te miratuar) qe mbahet nga zyra doganore mbikqyrese e regjimit ne permbyllje te tij (sipas Aneksit te Udhezimit nr. 01, date 06.09.2012 "Mbi zbatimin praktik te Regjimit te Përpunimit Aktiv" i ndryshuar") do te pasqyrohen te gjitha ndryshimet/shtesat e miratuara.

7. Në pikën 2 të nenit 3 në të cilën përcaktohen dokumentat që duhet të paraqiten në DPD bashkëlidhur kërkesës për rinovimin e autorizimit të RPA duhet të shtohen dhe të gjitha kopjet e shkresave me ndryshimet/shtesat e miratuara nga degët doganore mbikqyrese.

8. Ky udhezim hyn ne fuqi menjehere dhe i fillon efektet per delegimin e kompetencave në datën 1 Prill 2016.

Pranëra FAGU (BEHUSHI)

DREJTORI PËRGJITHSHËM

